

II.1 Ligji nr 9492 datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”¹

L I G J

Nr. 9492, datë 13.3.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR
KORRUPSIONIT

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, miratuar në Nju-Jork më 31 tetor 2003.

Neni 2

Në zbatim të pikës 3 të nenit 6 të Konventës, autoriteti që mund të asistojë shtetet e tjera palë në zhvillimin dhe zbatimin e masave të veçanta për parandalimin e korrupsionit është Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave.

¹ Ky dokument i referohet publikimit të bërë nga Qendra e Publikimeve Zyrtare, Gazeta Zyrtare nr 27. Viti 2006

Neni 3

Në zbatim të shkronjës "a" të pikës 6 të nenit 44 të Konventës, Republika e Shqipërisë e pranon këtë Konventë si bazë ligjore në bashkëpunimin me shtetet e tjera palë të Konventës për ekstradimin.

Neni 4

1. Në zbatim të pikës 13 të nenit 46 të Konventës, autoriteti qendror përgjegjës dhe i autorizuar, për të marrë kërkesa për ndihmë të ndërsjellë ligjore, si dhe për t'i ekzekutuar ose transmetuar ato në organet përkatëse për ekzekutim është Prokuroria e Përgjithshme për kërkesat për hetimin dhe procedimin penal dhe Ministria e Drejtësisë për kërkesat gjatë gjykimit dhe ekzekutimit të dënimit, si dhe për kërkesat për ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar.

2. Në zbatim të pikës 14 të nenit 46 të Konventës, gjuha e pranueshme për Republikën e Shqipërisë është gjuha shqipe dhe, nëse nuk arrihet, përkthimi i certifikuar zyrtarisht në shqip.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4820, datë 28.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu.